



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Komisioni për Sigurinë Kombëtare

PROCESVERBAL

Tiranë, më 02.02.2021, ora 11:30

Drejton mbledhjen:

Ermonela Felaj – kryetare e Komisionit

Rendi i ditës:

Diskutimi i projektligjit “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 75/2014 “Për shërbimin privat të sigurisë fizike”, i ndryshuar”.

Marrin pjese: Ermonela Felaj, Antoneta Dhima, Elena Xhina, Elona Gjebrea, Xhemal Qefalia, Edmond Rrushi, Edmond Stojku, Artemisa Malo, Luan Duzha, Lefter Maliqi, Ylli Shehu, Nimet Musai, Myslim Murrizi, Sadi Vorpsi dhe Spartak Braho.

Mungojnë:

Alban Zeneli, Arben Elezi, Anduel Xhindi, Luan Harusha dhe Paulin Sterkaj.

Të ftuar:

Selami Jenishehri – Deputet i Kuvendit të Shqipërisë.

Ermonela Felaj – Kolegë, vazhdojmë me pikën e dytë të rendin të ditës, që, sikundër jua bëra me dije pak më herët, është diskutimi i projektligjit “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 75/2014 “Për shërbimin privat të sigurisë fizike”, i ndryshuar”.

Ky projektligj është iniciativë e deputetit Selami Jenishehri dhe është parashikuar të diskutohet në Komisionin e Ligjeve dhe në Komisionin e Sigurisë.

Pak më herët, ndërkohë që ne zhvillojmë pikën e parë të rendit të ditës në mbledhjen e sotme, iniciativa është prezantuar në Komisionin e Ligjeve.

Pa humbur kohe, unë dua t’ia kaloj fjalën zotit Jenishehri për të bërë prezantimin e nismës së tij.

Cila është nisma që do të prezantoni sot pranë Komisionit të Sigurisë? Ku konsiston kjo nismë dhe për çfarë do të shërbejë?

Zoti Jenishehri, fjala është për ju.

Selami Jenishehri – Në Republikën e Shqipërisë kemi ligjin nr. 75/2014 “Për shërbimin privat të sigurisë fizike”. Ky ligj flet për një shërbim që bëhet me anë të tij.

Idea jonë është që këtij shërbimi t’i shtojmë edhe një shërbim shtesë për detektivët privatë, meqenëse detektivi privat në Republikën e Shqipërisë kryen një aktivitet, që nuk është në kundërshtim me Kushtetutën dhe nuk zhvillohet në përputhje me një ligj, ku detektivi privat të ketë të përcaktuar të drejtat, detyrat e me radhë.

Sa herë që ndodh kështu, sipas meje, ne e rregullojmë legjislacionin shqiptar, që Shqipëria të mos jetë një vend me ligj, pa ligj, ku njerëzit të ushtrojnë aktivitete që nuk janë në përputhje me një ligj. Veprimtaria e detektivit privat nuk kundërshtohet nga Kushtetuta, por duke e disiplinuar, ne do të kemi një legjislacion më të rregullt dhe më konkret, në mënyrë që njerëzit të mos kryejnë aktivitete abuzive si t’ua marrë mendja, pavarësisht se Kushtetuta nuk i pengon ata.

Unë kam biseduar me drejtorin e shkollës së detektivëve privatë dhe atyre u intereson një shtesë e tillë në shërbimin privat të sigurisë fizike. Pra, këtij shërbimi t’i shtohet shërbimi i detektivit privat dhe, në këtë mënyrë, aktiviteti bëhet më ligjor dhe i shërben më mirë ligjit shqiptar.

Në këtë kuadër, unë e kam paraqitur për aprovim projektligjin, pavarësisht se çfarë vullneti kanë njerëzit për t’i dhënë jetë dhe për të përmirësuar legjislacionin shqiptar, pasi detyra jonë si deputetë është ta çojmë përpara jetën e shqiptarëve, të mos kemi ligje, që nuk janë ligje.

Për shembull, në legjislacionin shqiptar neni 315 i Kodit Penal është i shfuqizuar. Me shfuqizimin tij gjyqtarët kanë të drejtë të marrin një vendim që dihet se është i padrejtë dhe nuk

u thotë askush gjë. Pra, nuk dënohen për këtë veprim. Në këtë mënyrë, ai ta merr pronën, dhe atë që është i dënuar me burgim të përjetshëm, gjyqtari mund ta lirojë, duke thënë “unë kam marrë këtë vendim”. Pra, ai del nga burgu dhe gjyqtari nuk dënohet.

Unë e them këtë gjë sa herë që jam në parlament, me qëllim që të vihet në fuqi edhe një herë ky ligj. Si mund të ketë të drejtë dikush të japë një vendim, kur dihet që ai vendim është i padrejtë, dhe të mos mbajë asnjë përgjegjësi?

Mendoj se idetë e mia janë në shërbim të shqiptarëve dhe duhet të merren parasysh nga specialistët e Ministrisë së Drejtësisë, sepse unë nuk jam jurist. Askush nuk merr iniciativën ta rregullojë këtë legjislacion dhe kanë vullnetin që Shqipëria të jetojë në një shtet pa shtet.

Megjithatë, unë kam mendimin tim, kam përgjegjësinë e detyrës së deputetit dhe kam propozuar këtë projektligj.

Projektligji flet për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 75/2014 “Për shërbimin privat të sigurisë fizike”, i ndryshuar”. Në mbështetje të neneve 78 dhe 83, pika 1 e Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave, Kuvendi i Republikës së Shqipërisë vendosi që në ligjin nr. 75/2014 të bëhen këto ndryshime:

Ndryshohet titulli dhe përmbajtja, si me poshtë vijon:

Neni 1: “Ky ligj ka si qëllim rregullimin e veprimtarisë së shërbimit privat të sigurisë fizike dhe të detektivit privat në Republikën e Shqipërisë”.

Në nenin 2 shtohet shkronja “c”, si me poshtë vijon:

c) Rregullimi i profesionit të detektivit privat.

Në nenin 3 shtohet pika 28 me shkronjat “a”, “b”, “c” dhe “ç”, si më poshtë vijon:

Pika 28: “Shërbimi i detektivit privat ofrohet nga subjekti privat i licencuar, i cili”:

a) heton dhe jep informacione për karakterin ose veprimet e një personi, për natyrën e biznesit, ose për profesionin e një personi e të tjera;

b) kontrollon shkelësit kundër ligjit, personat e humbur ose pronën;

c) kryen blerje ose shërbime të tjera në rroba civile ose të thjeshta për një klient, me qëllimin e raportimit ndaj klientit për sjelljen, integritetin ose besueshmërinë e punonjësve të klientit ose personave të tjerë;

ç) kryen shërbime me rroba civile ose të thjeshta për parandalimin ose zbulimin e vjedhjeve.

Kreu II “Certifikimi dhe licencimi”:

Në nenin 4 shtohet togfjalëshi "detektiv privat", si më poshtë vijon:

“Subjektet e SHPSF-së dhe detektivi privat, gjatë ushtrimit të veprimtarisë së tyre, u nënshtrohen parimeve të përgjithshme, si: parimi respektimit të lirive dhe të drejtave të njeriut,

i mosdiskriminimit, i ligjshmërisë, i profesionalizmit, i objektivitetit dhe detyrimi për të parandaluar konfliktin e interesit”.

Në nenin 5 shtohen pikat 8, 9 dhe 10/a/b/c/c/d/dh/e/e/f/g/h, si më poshtë vijon:

Pika 8: “Profesioni i Detektivit Privat rregullohet me ligjin Nr. 10081/2009 dhe VKM-në nr. 538/2009, referuar Listës Kombëtare të Profesioneve të Lira të Republikës së Shqipërisë”.

Pika 9: “Certifikimi i detektivit privat është kompetencë e Qendrave të Formimit Profesional të licencuara nga QKB-ja në përputhje me ligjin nr. 10081/2009 dhe VKM-në nr. 538/2009 ...

Ermonela Felaj – Zoti Jenisheri, më falni, por nuk është nevoja t’i lexojmë të gjitha nenet, sepse kolegët i kanë përpara. Ideja ishte prezantimi i përmbajtjes dhe qëllimi, për të cilin e keni propozuar. Pra, edhe për eficiencë kohe, besoj se leximi i nismës është i tepërt, ndërkohë që të gjithë deputetët e kanë përpara. Unë mendoj të dëgjojmë edhe kolegët e tjerë të Komisionit të Sigurisë Kombëtare.

Faleminderit!

Kolegë, besoj se deputeti Jenishehri ishte i qartë në atë që i propozon Kuvendit të Shqipërisë. Propozimi konsiston në bërjen pjesë në ligjin “Për shërbimin privat të sigurisë fizike” edhe shërbimi që sot jepet nga detektivët privat. Në fakt, ka disa nene, ku propozohet të ndryshohet ligji nr. 75/20114 “Për shërbimin privat të sigurisë fizike”, por, para se të fillojmë diskutimin me ju, dua t’ju bëj me dije se ky projektligj është diskutuar pak më herët në Komisionin e Ligjeve dhe nuk është votuar në parim. Qëndrimi nuk ka të bëjë më shumë me përmbajtjen sesa me konceptin në vetvete. Sipas asaj që referohet edhe nga Komisioni i Ligjeve, gjë të cilën unë e kam detyrim t’ju bëj me dije, si kryetare e Komisionit të Sigurisë, është se qëndrimi në raport me detektivët privatë mendohet të bëhet pjesë e një ligji të veçantë, sepse akti ligjor që duhet të ndërmerret për rregullimin e pozitës së detektivëve privatë në Shqipëri, nuk ka pikëpreje me shërbimin privat të sigurisë fizike, i cili rregullohet me ligj të veçantë.

Aktualisht qenia si detektiv privat konsiderohet profesion i lirë, i cili ushtrohet përkundërt licencimit. Këto janë 2 rregullime ligjore të shprehura në një vendim të Këshillit të Ministrave, vendimi nr. 538/2009, i cili përmban listën kombëtare të profesioneve të lira në Republikën e Shqipërisë, ku është edhe ligji nr.1081 datë 23.02.2009 “Për licencat, autorizimet dhe lejet në Republikën e Shqipërisë”. Pra janë këto 2 akte, një akt nënligjor dhe ligji ku gjen rregullim profesioni i detektivit. Edhe më parë, gjithmonë në publik është hedhur ideja që duhet të ketë një ligj të veçantë për rregullimin e këtij profesioni të lirë, i cili para disa vitesh ishte në

fillimet e veta, por sot me sa duket është zgjeruar dhe ka plot njerëz që e ushtrojnë si profesion; ka një shoqatë të detektivëve privat dhe një shkollë të detektivëve privatë. Të paktën, ky është informacioni që mund ta aksesoni dhe mund ta keni të gjithë.

Diskutimi ku unë dua të ndalem me të gjithë ju është pikërisht ky:

A është e përshtatshme? A është gjëja e duhur që detektivët privatë si profesion të gjejnë rregullim në ligjin “Për shërbimin privat të sigurisë fizike”? A ka ndonjë gjë të përbashkët midis objektit të punës së shërbimit të sigurisë fizike dhe objektit të punës së detektivëve privatë?

Dua të bëj edhe një kujtesë tjetër, për t’i dhënë pak hov diskutimit që ligji për shërbimin privat të sigurisë fizike është një ligj i propozuar nga Ministria e Brendshme. Pra, flas për ligjin nr. 75/2014, i cili ka marrë shumë kohë diskutimi në komisionet parlamentare, të Ligjeve dhe të Sigurisë Kombëtare. Ndërkohë, gjatë këtyre viteve nuk ka pasur ndonjë projekt të propozuar për profesionin, sepse kështu konsiderohet në legjislacionin tonë, e lirë të detektivit privat.

Fjala është për ju, nëse keni pyetje apo diskutime për kolegun Jenishehri apo mes nesh. Kush e do fjalën?

Po, zonja Gjebrea.

Elona Gjebrea – Faleminderit, zonja kryetare!

Të nderur kolegë,

I nderuar zoti koleg deputet që prezanton nismëm sot, Jenishehri, unë kam një pyetje. Nuk e dëgjova mirë dhe për këtë kërkoj ndjesë, por për efekt të audios nuk e kam dëgjuar, a keni pasur konsultime me përfaqësues të institucioneve përkatëse, si me ata të Ministrisë së Brendshme apo të Policisë në lidhje me propozimin tuaj? Ju i referoheni ligjit për sigurinë publike, por, ndërkohë, edhe kryetarja e tha, ka edhe disa informacione që ne kemi për sa i përket punës që bëjnë detektivët privatë dhe nevojës që ju parashtroni. Pra, me kë jeni konsultuar? A keni ndonjë informacion se si e kanë vendet e tjera të zhvilluara këtë nismë, që ju parashtroni?

Faleminderit!

Ermonela Felaj – Faleminderit, zonja Gjebrea!

Atëherë zoti Jenishehri fjala për ju. Mund t’i përgjigjeni pyetjes së zonjës Gjebrea.

Selami Jehnishi – Fillimisht ideja ime ishte krijimi i ligjit për detektivin privat, prandaj unë jam konsultuar me njerëzit më të mirë që e njohin këtë projektligj dhe aktivitetin e detektivit privat. Në bisedat që kam zhvilluar me drejtorin e shkollës për detektiv privat, i cilin mendoj se duhej thirrur këtu në komision, si grup interesi, që ta dëgjonit vetë, se mbase argumentet e tij do të jenë më profesionale se të miat, kam kuptuar që detektivi privat ushtron

një aktivitet, i cili nuk është në kundërshtim me Kushtetutën, por është evaziv dhe ka hapësira që ata i zmadhojnë dhe i zvogëlojnë vetë. Mendimi im është se këta njerëz duhen të disiplinohen dhe t'i vendosim në ligj të drejtat dhe detyrat për ushtrimin e këtij aktiviteti. Meqenëse ekziston një shërbim privat siç është ai i sigurisë fizike, kam propozuar t'i shtojmë këtij shërbimi dhe një shërbim tjetër, pra t'i shtojmë sigurimit fizik edhe shërbimin tjetër të detektivit privat. Sipas meje, asnjë gjë të keqe nuk ka. Në qoftë se ky projektligj për të cilin po flas do ta çonte mbrapa legjislacionin tonë, nuk do t'u shërbente shqiptarëve, atëherë unë do të pajtohesha me ju nëse nuk do ta pranoni këtë projektligj, por përderisa një gjë e tillë nuk ekziston, përse të mos e përmirësojmë e ta rregullojmë dhe këtij shërbimi t'i shtojmë dhe shërbimin tjetër dhe në këtë mënyrë detektivi privat të mos ketë të drejta për të ushtruar aktivitete dhe veprimtari që nuk janë në kundërshtim me Kushtetutën, por nuk i ka të caktuara me ligj? Pra, të vendosim ligj edhe për atë. Ai të punojnë dhe të veprojnë me ligjin e vet. Kjo është ideja ime dhe, kur jam konsultuar me drejtorin e detektivit privat dhe me zonjën që drejton aty, ata e kanë quajtur me shumë vend dhe më kanë falënderuar për idenë time që ta përmirësojmë legjislacionin, se ne deputetë jemi dhe detyra jonë është të çojmë para gjithçka në jetën e shqiptarëve, edhe legjislacionin, që të plotësohet dhe ne... Prandaj ne nuk jemi në Europë, sepse ata e kanë, ndërsa ne nuk e kemi. Në fund të fundit, unë jam deputet dhe me profesion jam mësues matematike, nuk jam jurist, por, sipas meje, juristët nuk e kryejnë detyrën që kanë. Në qoftë se duam ta vendosim si ligj të veçantë, le ta kishin propozuar ose le ta propozojnë, se nuk po i pengon ndokush, por këtu më duket se nuk ka vullnet që legjislacioni ynë të jetë i duhuri, në përputhje me të gjitha shtetet e Bashkimit European, që ne ta çojmë Shqipërinë para. Njerëzit këtu nuk kanë vullnet për të punuar, për të kryer detyrën e deputetit, pavarësisht se janë juristë të mirëfilltë e me radhë. Megjithatë, unë e kreu detyrën time, kam vullnetin, dëshirën dhe respektin, që e kam nga populli im, që më ka vendosur deputet. Kurrkush nuk i ka penguar këta juristë (isha në Komisionin e Ligjeve) për ta bërë me ligj këtë. E njëjta gjë është edhe në qoftë se i shtojmë shërbimit të sigurisë dhe shërbimin tjetër. Përderisa kjo gjë nuk e ka çon mbrapa, por e çon para jetën e shqiptarëve, ne duhet ta aprovojmë këtë projektligj.

Nëse ju nuk keni vullnet për ta çuar para jetën e shqiptarëve, votojeni kundër, asnjë gjë nuk më gjen mua. Unë para shqiptarëve di të flas dhe ata e kuptojnë që kam ardhur këtu para ta çuar jetën e tyre para dhe detektivi privat është e arsyeshme të ketë ligj dhe të mos bëjë çfarë të dojë, pavarësisht se ai nuk vepron në kundërshtim me Kushtetutën, por duhet të ketë ligjin dhe aktiviteti i tij të mos kalojë caqet e të drejtave që ka dhe legjislacioni shqiptar të jetë sa më i barabartë me Shtetet e Bashkuara të Amerikës dhe vendet e Bashkimit European. Po nuk e

bëmë këtë gjë, nuk e kemi kryer detyrën e deputetit, nuk e kemi çuar jetën e shqiptarëve para. Jemi dhe profesionistë të mirë, aq më tepër nëse je dhe jurist dhe hesht, sepse nuk ke ardhur në parlament për të qëndruar në karrige, por për të propozuar dhe për ta lodhur mendjen që jeta e shqiptarëve të shkojë para. Unë e kuptoj që ky vullnet mungon. Unë jam një deputet dhe më quajnë se jam i opozitës, por, në fakt, unë nuk jam i opozitës, por i atyre që më vënë projektligje përpara, të cilat unë i votoj gjithmonë kur e çojnë jetën e shqiptarëve para dhe nuk shoh nëse e ka sjellë Partia Socialiste apo Partia Demokratike, unë e lexoj ligjin, konsultohem, se konstatoj që e çon jetën para. Këtë gjë kam bërë edhe në këtë rast. Ju keni të drejtë për ta rrëzuar, vazhdoni, ishalla ju ndihmon Zoti dhe ecni para!

Ermonela Felaj – Faleminderit, zoti Jenishehri!

Gjithsesi, procedura kërkon që ne të respektojmë, së pari, procedurën që vendos Rregullorja e Kuvendit të Shqipërisë, që do të thotë se, pasi ju prezantuat nismën tuaj, deputetët kanë të drejtë të bëjnë pyetje dhe ju të jepni përgjigje pa paragjykuar pyetjet e askujt. Në këtë rast, besoj se njëra nga përgjigjet, se kush ka qenë i interesuar për ta prezantuar këtë nismë në Kuvendin e Shqipërisë, u dha nga ana juaj, ndërkohë që presim dhe një përgjigje për pyetjen tjetër: a ka një model që ju e keni parë vetë brenda Bashkimit European, që të jetë i njëjtë apo i ngjashëm me këtë që na propozohet? Pra, a ka vende të tjera të Bashkimit European, ku bashkë me shërbimin privat të sigurisë fizike rregullohet dhe detektivi privat? Po apo jo? Më pas komentet t'ia rezervojmë secilit, që t'i bëjë në diskutimin e vet.

Selami Jenishehri – E qartë.

Ndër shtetet e Bashkimit European ekziston ligji për detektivin privat dhe për këtë gjë kam pyetur ata që janë profesionistë, që drejtojnë dhe shkollën e detektivit privat dhe ma merr mendja që para se ta propozoja këtë projektligj e kam kryer detyrën time për t'u konsultuar me njerëz dhe me grupet e interesit. Do të më bëhej qejfi nëse do t'i ftonit grupet e interesit dhe ndoshta ato do t'jua shpjegonin dhe më mirë se unë këtë që po më pyesni. Gjithsesi, përgjigja ime është shumë e shkurtër: kam lexuar që në Bashkimin European ka ligje për detektivin privat dhe nëse ne duam që legjislacionin tonë ta përafrojmë me ta, meqenëse kemi dëshirë dhe interes të shkojmë në Bashkimin European, duhet ta bëjmë. Sa herë që nuk e bëjmë këtë gjë, sa herë që krijojmë vetë diferenca, kur na vijnë këto projektligje për t'i aprovuar dhe nuk i aprovojmë, ata kuptojnë që ne nuk kemi vullnet dhe dëshirën për të shkuar atje dhe i kemi vetëm me fjalë këto, por atje nuk mund të shkojmë kurrë nëse legjislacioni i Shqipërisë nuk është njësoj me ta. Ju vetëm lodheni kot kur thoni që ne duhet të shkojmë në Bashkimin European, ndërkohë që e rrëzoni këtë projektligj, kur nuk u jepni të drejtë të shqiptarëve që edhe ata të kenë

detektivin privat, që e rregullon jetën e shqiptarëve shumë më shumë. Megjithatë, është detyra juaj...

Ermonela Felaj – A ka pyetje të tjera nga kolegët?

U lutem kolegëve të kenë akses me figurë para se të votojmë! A ka diskutime të tjera?

Po, zonja Xhina.

Elena Xhina – Faleminderit!

Do t'ju kërkoja leje të flisja pa kamera për shkak të linjës së dobët, sepse më ikën figura nëse e mbaj...

Për sa i përket propozimit të zotit Jenishehri, të cilin e falënderoj për iniciativën dhe dëshirën e mirë, do të nisesha pikërisht nga fjala e tij e fundit, që ne jemi deputetë dhe duhet të bëjmë detyrën tonë, dhe pikërisht detyra jonë është të bëjmë ligje sa më të mira dhe jo ligje për të kënaqur ndoshta dëshirat e grupeve të ndryshme të interesit për momentin. Tani, ligji ku zoti Jenishehri kërkon të adresojë këtë ligj të ri, këto ndryshime të reja, është ligji për shërbimin privat të sigurisë fizike, i cili, në fakt, ka si objekt të tij sigurimin fizik të objekteve, sigurimin e shoqërimit të vlerave monetare e të tjera si këto. Pra, nuk shohim asnjë përputhje midis objektit që kërkon të rregullojë zoti Jenishehri, që është rregullimi i veprimtarisë së shërbimit të detektivëve privatë, dhe ligjit që ne jemi duke diskutuar. Pra, është krejt e pavend që në këtë ligj të adresojmë këto ndryshime të reja që kërkon zoti Jenishehri.

Edhe unë jam shumë dakord që duhet të ketë një ligj për detektivët privatë, por, ama, duhet të jetë një ligj i mirëmenduar, ku duhet të punojë një grup i madh pune, me ekspertë dhe grupe interesi dhe duhet të marrim modelet më të mira të vendeve të Bashkimit Europian, si dhe duhet të jetë një ligj si ligji për profesionet e lira, që të jetë i plotë, gjithëpërfshirës dhe me korniza të qarta.

Duke qenë para këtij fakti, që ndryshimet ligjore adresohen në një ligj, ku nuk ka lidhje fare objekti, fusha e veprimit apo qëllimi i ligjit, mendoj se duhet të ishte një nismë më e mirëmenduar dhe nuk jemi në kushtet që ta pranojmë këtë propozim, me gjithë respektin për zotin Jenishehri.

Faleminderit!

Ermonela Felaj – Faleminderit, Elena!

Do t'u kujtoja kolegëve të hynin... Zoti Braho, zoti Qefalia, zoti Vorpsi, ju lutem të keni akses në sistem!

Zoti Braho, a keni ndonjë opinion për nismën e sotme? Edhe për shkak të përvojës, do të ishte gjithmonë me interes që t'ju dëgjonim, nëse mundeni.

Spartak Braho – Jam dakord me mendimet.

Thuaj relatorit të ketë kujdes kur zë në gojë juristët, se ai nuk e kupton fare se çfarë do të thotë të jesh jurist; është racë e veçantë!

Ermonela Felaj – Po presim dhe kolegun Vorpsi që të hyjë në linjë dhe mund të votojmë.

Selami Jenishehri – A t'i jap një përgjigje këtij, të lutem?

Ermonela Felaj – Të mos e bëjmë debat, se...

Selami Jenishehri – Po më thotë që nuk e di se kush është juristi dhe dua t'ia tregoj se kush është.

Ermonela Felaj – Kolegë, unë e shpreha dhe në fillim të mbledhjes që ka një qëndrim të shprehur nga Komisioni i Ligjeve, që e rrëzon në parim këtë nismë, për shkak se e sheh pa asnjë lloj lidhjeje logjike që shërbimit privat të sigurisë fizike t'i atashohet dhe detektivi privat, thjesht dhe vetëm duke e konsideruar atë si shërbim. Bërja e çdo propozimi të ri, qoftë ky ligj i ri, qofshin ndryshime apo shtesa në ligj, kërkon një proces të tërë të të menduarit, reflektuarit dhe krahasuarit njëkohësisht, gjë që në rastin e nismës konkrete nuk mund të justifikohet, pavarësisht qëllimit të mirë ose, le të themi, qëllimit pozitiv, sepse ndoshta nuk kemi të drejtë ta paragjykojmë. Është një realitet ky që ndodh në Shqipëri, që ka një numër detektivësh privatë që ushtrojnë aktivitet, ka po ashtu një numër qytetarësh që e shohin si një mundësi për t'iu drejtuar detektivit privat dhe e përdorin atë për nevojat e tyre. Çështja nëse kjo duhet rregulluar me ligj apo me një akt tjetër të një karakteri më të ulët meriton një diskutim të veçantë. A është i njëjtë shërbimi privat i sigurisë fizike me të qenit detektiv privat? Sigurisht që nuk kanë asnjë pikë lidhjeje me njëra-tjetrën.

E fundit që doja të thosha është se qenia jurist nuk supozon detyrimisht që çdo gjë të vihet përpara në trajtën e një ligji të të bërë ty ta pranosh symbyllur, sepse pikërisht për këtë je jurist, që ta shohësh, ta lexosh, ta konfrontosh, ta gjykosh dhe në fund të vendosësh.

E thashë, ne jemi dhe para një pengese, që unë e gjykoj të njëjtë. Nëse do të bëja një krahasim, gjatë procesit të hartimeve të projektligjeve, nëse Ministria e Drejtësisë do të dilte kundër, ky akt nuk do të kalonte në Këshillin e Ministrave. Pra, Ministria e Drejtësisë është e vetmja ministri rregullatore që ka të drejtën të ndërpresë rrugëtimin e një akti të propozuar nga cilado ministri tjetër, pikërisht me të drejtën e të qenit profesionistë të drejtpërdrejtë të ligjit. E njëjta gjë ma do mendja se vlen si krahasim edhe brenda Kuvendit të Shqipërisë. Jo më kot ne kemi 8 komisione parlamentare (Komisioni i Ligjeve është një komision që në përbërje ka kryesisht juristë) për të vlerësuar pikërisht këtë lloj diskutimi që ne jemi duke bërë sot me kolegun Jenishehri.

Kështu që në përfundim, duke besuar që secili prej jush i ka krijuar tanimë opinionet e veta, do t'ju ftoja të votonim.

Kush është dakord me nismën e propozuar nga Jenishehri “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.75/2014 “Për shërbimin privat të sigurisë fizike”, i ndryshuar””? Kundër? Abstenim? Nuk ka.

Rrëzohet nisma në fjalë.

Ju faleminderit, kolegë!

Faleminderit, zoti Jenishehri, për prezencën tuaj në Komisionin e Sigurisë!

Ditë të mirë, kolegë!

Dëgjohemi në mbledhjen e ardhshme!

MBYLLET MBLEDHJA